


ORDO FRATRUM MINORUM



Kush ka veshë le të dëgjojë  
çka Shpirti Shenjt u thotë  
... Fretërve minorë sot

Dokument i Këshillit Plenar OFM  
12-28 qershor 2018  
Nairobi, Kenia

ROMË 2018

















Qor	Qortimet
KK	Kënga e Krijesave
LU	Letra drejtuar gjithë Urdhrit
RrV	Rregulla e Vulosur (1223)
RrP	Rregulla e Pavulosur (1221)

### **C. Biografi të shën Françeskut të Asizit**

1Cel	Jeta e shën Françeskut [Biografia e parë] - Tommaso da Celano.
2Cel	Memorial në dëshirën e shpirtit [Biografia e dytë] - Tommaso da Celano.
LegjM	Legjenda Maxhore - Bonaventura da Bagnoregio.
Lul	Lulëzat e shën Françeskut
LegjPer	Legjenda Peruxhiane

### **D. Të tjera**

KGJ/10	Kushtetutat Gjenerale të Urdhrit të Fretërve Minorë, Romë 2010.
SGJ/10	Statutet Gjenerale të Urdhrit të Fretërve Minorë, Romë 2010.
EG	Evangelii Gaudium. Nxitje Apostolike e Atit të Shenjtë Françeskut, 2013.
GE	Gaudete et Exultate. Nxitje Apostolike e Atit të Shenjtë Françeskut, 2018.







duke treguar pak ose aspak interes për *Evangelii Gaudium*, *Laudato si'* dhe *Amoris Laetitia*.

7. Së fundi, duke shikuar statistikat mund të shihet se edhe Kisha është në lëvizje dhe janë duke u rritur numerikisht katolikët e pagëzuar. Kjo mund të shqyrtohet më thellë duke lexuar atë që ka publikuar Sekretaria e Shtetit të Vatikanit në Vjetarin Papnor 2017, i disponueshëm në sitin:

<https://press.vatican.va/content/salastampa/it/bollettino/>

i publikuar/2017/04/06/0222.html (i vizituar më 29.06.2018).

8. “Numri i katolikëve të pagëzuar ka shkuar duke u rritur në nivel planetar, duke kaluar nga 1.272 milionë në vitin 2014, në 1.285 milionë në vitin 2015, me një rritje relative me 1%”. Por kjo lëvizje e rritjes mund të vërehet në disa kontinente ndërsa në të tjerë shihet pakësim. Në të vërtetë, nga viti 2010, në Afrikë regjistrohet një shtim me 19,4% të katolikëve të pagëzuar, në Azi me 9,2%, në Amerikë me 6,7%, ndërsa në Evropë dhe Oqeani vërehet njëfarë qëndrueshmërie, edhe pse ka pasur një pakësim me rreth 1,5%.

9. Për sa i përket jetës rregulltare mashkullore, rregulltarët me kushte jo meshtarë po pakësohen lehtësisht në nivel planetar, me një pakësim më të madh në Evropë, Amerikë dhe Oqeani, dhe me njëfarë rritjeje në Afrikë dhe Azi. Rregulltarët meshtarë janë “në rënie në Evropë dhe Oqeani, shfaqin një pakësim domethënës edhe në kontinentin amerikan, ku rezultojnë pak më shumë se 38 mijë në vitin 2015, nga më shumë se 40 mijë në vitin 2010”. Nga ana tjetër, “Afrika, Amerika Qendër-Kontinentale dhe ajo e Jugut, si dhe Azia Juglindore shohin të shtohet pesha e tyre nga viti 2010 në vitin 2015” (krh. siti i lartpërmendur).



## ***Të dëgjojmë realitetin dhe shenjat e kohëve. Disa tekste për të reflektuar***

**10.** “Fretërit minorë, të përfshirë në popullin e Hyjit, të vëmendshëm ndaj shenjave të kohëve dhe duke iu përgjigjur kushteve të botës që ndryshon, të jenë gjithmonë besnikë ndaj të ndierit të Kishës, të bashkëndajnë nismat e propozimet e saj dhe t’i mbështesin ato sipas mundësive të veta”; “Fretërit «për dashuri shpirti me gjithë qejf t’i shërbejnë dhe t’i binden njëri-tjetrit» (RrP V, 14) duke kërkuar së bashku shenjat e vullnetit të Zotit Hyj”; “Është e nevojshme të vërejnë me kujdes shenjat e kohëve dhe t’i interpretojnë ato në dritën e Ungjillit” (KGJ 4,1; 7,3; 102,2).

**11.** “Formimi i përhershëm e aftëson fratin minor që të marrë një qëndrim soditës të aftë për të dëgjuar Hyjin” (RFF 111).

**12.** “Të krishterët, të zhytur në punët dhe në shqetësimet e kësaj bote, por të thirrur edhe ata në shenjtëri, kanë nevojë të gjejnë në ju zemra të pastuara që në fe «shohin» Hyjin, persona të dëgjueshëm ndaj veprimit të Shpirtit Shenjt që ecin shpejt në besnikëri ndaj karizmës së thirrjes dhe të misionit” (JK 109).

**13.** Në KPU u është bërë referim tematikave të shumta komplekse që kanë lidhje me njerëzimin, Kishën dhe Urdhrin. Këtu po sjellim vetëm çka i referohet Urdhrit, duke paraqitur disa aspekte kritike që mendojmë se janë sfida që duhen përballuar në këtë kohë, ashtu si edhe atë që e karakterizon pozitivisht. Një thesar të mirë të paçmueshëm që reflekton kudo një dritë të Krishtit dhe është më e madhe se hijet e ndryshme.





## **Jeta shpirtërore dhe jeta vëllazërore e Fretërve minorë sot**

17. Përveç të dhënave të bashkëndara në KPU, në këtë seksion të kushtuar dëgjimit mund të na ndihmojë edhe referimi në studimin mbi Urdhrin e Fretërve minorë në botë, i përfunduar në 2013 dhe i koordinuar nga prof. Renato Mion, i Institutit të Sociologjisë të Universitetit Papnor Salezian të Romës, i cili nxjerr në dritë disa vështirësi që ndikojnë në jetën shpirtërore dhe françeskane. Prej dëgjimit të fretërve kanë dalë në pah aspektet që vijnë.

### *Vështirësi në leximin e shenjave të kohëve*

18. Prej përgjigjeve të dhëna mund të pohohet se dimensionin e vëmendjes ndaj “shenjave të kohëve”, si shtytje dhe motivim ideal për përshtetësinë personale, është zëvendësuar prej mbizotërimit të një vëmendjeje të privilegjuar ndaj kontekstit të drejtpërdrejtë, si territorial ashtu edhe personal, duke e vënë theksin në një *përshpirtëri të jetës së përditshme*. Bëhet fjalë për një zgjedhje që është bërë sidomos nga më të rinjtë.

### *Vështirësi në jetën shpirtërore*

19. Shfaqen me vetëdije mjaft të gjallë tregues të krizës për jetën personale shpirtërore, pra kujdesi i pamjaftueshëm për lutjen personale (41%), realitet që përbën rrezikun më të madh për jetën personale të fesë. Atë e shoqëron vështirësia konkrete që shkaktohet nga një ngarkesë e tepërt pune (34%), së cilës jo gjithmonë i përgjigjet një mbështetje e përshtatshme marrëdhëniesh të kënaqshme vëllazërore (30%) dhe drejtimi edhe shpirtëror nga ana e ministrave dhe guardianëve. Duket qartësisht realist perceptimi i një stili të përhapur jete borgjeze (26%) që mërzit dhe rrezikon ta dobësojë gjithnjë e më shumë vetë identitetin françeskan (25%).

### *Vështirësi në jetën vëllazërore*

20. Prej të dhënave të hetimit dalin në pah probleme në marrëdhëniet ndërpersonale dhe pasiguri të rëndësishme në lidhje me identitetin thirrur në Urdhër. Një problem i madh që përfshin gjysmën e fretërve (i deklaruar nga 46%), në çfarëdo rajoni që gjenden, është mungesa e komunikimit ndërpersonal. Bëhet fjalë për atë komunikim mes bashkëvëllezërve që ndërtohet në marrëdhëniet ndërpersonale të përditshme, të cilat do të duhej të ishin të përbëra



**24.** Një tjetër aspekt paraqitet prej ndjesisë së zemërimit të jetuar nga disa fretër në moshë të mesme. Në jetën e tyre nuk ka një identifikim të qartë me Urdhrin dhe karizmën e tij. Nga ana tjetër, ka shumë vëllezër të tjerë që e shohin të ardhmen me optimizëm, të bindur se karizma françeskane ka shumë për t'i dhënë botës së sotme.

**25.** Së fundi, në disa Entitete të Urdhrit mungon një projekt vëllazërie dhe misioni. Pjesa më e madhe e fretërve është e kushtuar baritores, por ekziston përfshirje e paktë si vëllazëri. Disa Konferenca janë duke u përpjekur t'i japin një stil vëllazëror misionit të çdo vëllazërie, në mënyrë që të jetojnë dhe t'u shërbejnë famullive dhe shenjtëroreve si fretër minorë, duke e bërë jetën vëllazërore si qendër mbështetëse të apostullatit. Sidoqoftë, prej relacioneve vihet në dukje një gjallëri shumë e madhe dhe domethënëse e Fretërve minorë në të gjitha Konferencat.

## **Prania e Fretërve minorë**

**26.** Në të gjithë botën, një prej karakteristikave që mbahet e gjallë në françeskanët, është afërsia me popullin, pavarësisht prej veprave që drejtojnë. Mikpritja, dëgjimi, shoqërimi, ndihma, puna e karakterizojnë Urdhrin kudo. Duhet shtuar pastaj se fretërit çmohen, edhe në vendet në të cilat Kisha e ka humbur besimin e shoqërisë. Pa dyshim figura e Françeskut të Asizit i shoqëron fretërit në çdo kontinent.

**27.** Në të gjitha entitetet e Afrikës, të Amerikës Latine, të Azisë dhe të Oqeanisë ka disa famulli në periferitë e varfra dhe shumë herë ka përfshirje të personave të thjeshtë si bashkëpunëtorë të misionit ungjillëzues dhe në rolin e drejtuesve të bashkësive katolike.

**28.** Në çdo Konferencë ka disa prani vëllazërisht dhe fretërisht mes grupeve të ndryshme të personave të përjashtuar, si për shembull personat me probleme droge dhe me të tjera vartësi, fshatarët pa tokë në Brazil dhe Amerikën Latine, personat e braktisur, fshatrat në pyje etj.

**29.** Është domethënëse prania e Fretërve minorë mes popullsive autoktone dhe mes autoktonëve të Amerikave, të Azisë dhe të Oqeanisë, me të cilët zhvillojnë veprimtari ungjillëzimi integral, duke promovuar të drejtat njerëzore



**34.** Çdo Provincë françeskane në Azinë Lindore përballon sfida të ndryshme në nivel politik, ekonomik e fetar. Ndërsa përmbajtja specifike e tensionit politik dhe e konflikteve ndryshon nga vendi në vend, françeskanët janë të nxitur të promovojnë paqen, pajtimin e drejtësinë dhe gjithashtu edhe t'u kushtojnë vëmendje të varfërve e të mënjanuarve të shoqërisë.

**35.** Në Konferencën Anglofone fretërit minorë e zhvillojnë shërbesën e tyre edhe për ata që janë në skajet e shoqërisë, veçanërisht të varfrit, të pastrehët, emigrantët dhe indigjenët. Provincat e Shën Gjon Pagëzuesit (Çinçinati), Santa Barbaras (Kaliforni) dhe Zojës së Guadalupe (Nju Meksiko) vazhdojnë një traditë më se njëshekullore duke u ofruar kujdes baritor vendasve amerikanë në Arizonë dhe Nju Meksiko. Shumë Provinca vazhdojnë prej dhjetëra vjetësh një shërbim baritor në bashkësitë historike të afro-amerikanëve.

**36.** Në Afrikë fretërit minorë janë të pranishëm dhe veprojnë në realitete shumë të varfra. Problemet shoqërore rriten me varfërinë, sëmundjet pandemike, në kontekste paqëndrueshmërie të madhe shoqërore e politike. Nga kjo rrjedh nevoja për të krijuar gjithnjë e më shumë struktura që mund t'i ndihmojnë personat që të kenë një jetë më dinjitoze.

## **Pritja e emigrantëve dhe refugjatëve**

**37.** Përballë situatës së rëndë të lëvizshmërisë njerëzore në rajonin që shkon nga Amerika Qendrore deri në Shtetet e Bashkuara, Konferenca Santa Maria e Guadalupe parashih banesa të përkohshme mbështetjeje për emigrantët dhe refugjatët kalimtarë në ato territore, pranë të cilave mund të gjejnë konsulencë juridike dhe asistencë sanitare për të gjitha nevojat që mund të ndeshin (uri, cenim të të drejtave njerëzore etj.). Duhet nënvizuar banesa “La 72, Hogar Refugio para Migrantes”, në Tabasko, ku kalojnë gati 15 mijë emigrantë dhe refugjatë në vit, dhe mbështetja ndaj nismave të laikëve që ndihmojnë emigrantët sikurse “Las Patronas”, në Verakruz, të dyja në Meksikë. Në “La 72, Hogar Refugio” të gjitha Provincat e Konferencës dërgojnë fretër në formimin fillestar për periudha që shkojnë nga një deri në gjashtë muaj.

**38.** Në Evropë shumë fretër minorë angazhohen për të pritur emigrantët dhe refugjatët. Në Itali Provincat janë përpjekur të ndërtojnë projekte, të kushtojnë kuvende të tëra, ose hapësira të kuvendeve dhe të finalizojnë veprën e fretërve



pranë njëri-tjetrit dhe shpesh bashkëndajnë të njëjtat vende të punës, të edukimit dhe, në rastin e të krishterëve, edhe të kultit. Ky dialog, shpesh, është e vetmja mënyrë për të ruajtur identitetin personal dhe për të mbrojtur të drejtat personale brenda një shoqërie me shumicë jo të krishterë. Një prej formave më efikase të dialogut janë takimet e ndërsjella në nivel institutesh të kulturës dhe të edukimit, sikurse rasti i Institutit Magnificat, shkollë muzike, që është i hapur për mësimdhënës dhe studentë hebrenj, të krishterë e myslimanë. Në Egjipt gjendet Qendra Françeskane e Musky-t, në Kairo, e specializuar në Studimet Lindore të Krishtera.

44. Fretërit që jetojnë në Siri flasin shpesh edhe për *ekumenizmin e gjakut*, sepse të krishterët e konfesioneve të ndryshme aty janë gjendur të gjithë të bashkuar në zgjedhjen për t'i qëndruar besnikë Jezu Krishtit, duke paguar shpesh edhe me gjakun e tyre.

45. Në Konferencën Jug-aziatike fretërit janë aktivë në proceset e zhdukjes: të fundamentalizmave socio-politike e fetare, të përndjekjes fetare dhe të konflikteve etnike duke u vënë në rolin e vepruesve të paqes e të harmonisë, duke themeluar bashkësi ndërfitare dhe kuvende të hapura si qendra të mikpritjes e të paqes. Ka disa teologë dhe disa barinj të përgatitur mirë në Entitetet që promovojnë integrimin në liturgji e në kult të tingëllueshmërive dhe të stileve muzikore të kulturave etnike e lokale të Azisë, duke favorizuar dialogut dhe një inkulturim më të madh me persona të feve të ndryshme.

46. Në Shtetet e Bashkuara mund të nënvizohet promovimi i bashkëpunimit ndërfitar. Për shembull, *Song and Spirit Institute*, i Provincës Shën Gjon Pagëzuesi, në Detroit, në hapësirën e caktuar për liturgjinë, mirëprent rregullisht kremtime të përbashkëta të Shabbat-it, rrethe myslimane të dialogut, takime meditimi të budistëve dhe mbledhje lutjeje të Kuakerëve (Protestantë).

## **Kujdesi për Botën e krijuar – DPIK**

47. Duke dëgjuar Konferencat ndihet vetëdija për faktin se kjo është një tematikë që ka lidhje me gjithë Familjen Françeskane dhe Lëvizjen Françeskane Drejtësi e Paqe, edhe pse Fretërit minorë që bëjnë pjesë në të janë të paktë, ndërsa prania më e madhe përfaqësohet nga anëtarët e OFS-së dhe RIFRA-s.





**53.** Fretërit e Konferencës Anglofone përpiqen të mishërojnë vlerat e DPIK me modalitete të ndryshme, mes të cilave mbrojtja e të varfërve dhe dëshira për të vënë në jetë *Laudato si'*. Fretërit maltezë janë duke realizuar *Projektin gjurmë karboni (Carbon Footprint Project)* për të ndihmuar fretërit që të rrisin vetëdijen e tyre për përdorimin e energjisë dhe për të pakësuar efektivisht me 30% në tre vjet sasinë e karbonit të prodhuar nga stilet e jetës së vëllezërive. Në Kanada, fretërit u japin zë shqetësimeve për ekologjinë e zhvillimit dhe angazhohen në mënyrë aktive për ta ruajtur tokën e për ta përdorur atë në mënyrë të përgjegjshme për mjedisin.

**54.** Në Konferencën Jugosllave fretërit promovojnë dhe nxisin një zhvillim ekologjikisht të përshtatshëm, së bashku me qendra eko-baritore në favor të ekologjisë.

**55.** Megjithatë, duhet të pranojmë se angazhimi nuk është i përgjithshëm, por i përket një numri të ngushtë personash. Disa fretër nuk mendojnë se DPIK është thelbësor për karizmën tonë; ose mendojnë se nuk mund të bëjmë asgjë për të ndryshuar situatën botërore; madje, për disa të tjerë problemi mjedisor nuk është real; ndërsa të tjerë janë të bindur se nuk bëhet fjalë për zgjedhje politike dhe partiake. Zakonisht në të gjitha Entitetet janë emëruar animatorë DPIK, por jo gjithmonë veprimtaria e tyre është e koordinuar, as nuk janë të pranishme struktura që e lejojnë këtë koordinim. Kurse formimi organizohen në të gjitha vendet; megjithatë, nuk vërehet një ndryshim domethënës qëndrimi i fretërve në jetën e zakonshme. Në disa anë realizohen projekte ripyllëzimi dhe riciklimi por kjo nuk ka një ndikim të madh në jetën personale të fretërve.

## **Veprimi Shoqëror**

**56.** Përveçse bashkëndajnë jetën me njerëzit në shumë vende, fretërit, së bashku me laikët dhe institucione të tjera, çojnë përpara projekte bamirësie dhe asistence shoqërore si qendrat për shëndetin, çerdhet, vendbanimet për të varfrit e emigrantët, qendrat e rikuperimit për të droguarit, me qëllim që t'u japin një përgjigje problemeve të drejtpërdrejta. Në pothuajse të gjitha Konferencat ka projekte zhvillimi njerëzor të shoqëruar nga fretërit minorë. Gjithashtu, promovohen shumë të rinjtë nëpërmjet itinerareve të formimit profesional, nëpërmjet ndihmës e mbështetjes ndaj popullsive autoktone e bashkësive rurale,



veprimtari të reflektimit mbi realitetin, në dritën e Ungjillit, duke u dhënë përgjigje praktike problemeve socio-kishtare.

**63.** Në Konferenca të ndryshme ka disa qendra apo shtëpi lutjeje në të cilat fretërit u japin të gjithëve një mundësi për thellimin e kërkimit të Hyjit dhe të përshpirtërisë, veçanërisht duke paraqitur trashëgiminë e pasur françeskane.

**64.** Teknologjitë e reja të komunikimit përfaqësojnë një “mjedis” të vërtetë ku personat jetojnë, takohen dhe i hapen bashkëndarjes. Si ungjillëzues, veçanërisht ndaj të rinjve, jemi të thirrur të jemi prani domethënëse edhe në botën digjitale.

**65.** Në disa Provinca të Amerikës së Jugut kanë nisur bashkëpunime me kanale televizive e radiofonike, dhe janë ideuar faqe web dhe Facebook.

**66.** Në Konferencën Anglofone ka disa fretër që përdorin masmediat për të ungjillëzuar sikurse e-mail-et, website-et, bllogjet, dhe videot në kanalin YouTube. Kështu çdo ditë janë në kontakt me qindra mijëra persona, zakonisht të rinj dhe të rritur. Së bashku me këtë prani në mediat, ka edhe vëllazëri të hapura për të pranuar të rinj për një përvojë konkrete jete me fretërit, meqenëse takimi personal nuk mund t’i delegohet kurrë botës digjitale.

## **Bota rinore**

**67.** Për sa i përket dimensionit rinor brenda Urdhrit, vihet në dukje se si në Konferenca të ndryshme ka fretër të rinj që reflektojnë stilet dhe kulturën e shoqërisë aktuale. Shumë familjarë me teknologjinë, rrezikojnë edhe ata që të jetojnë marrëdhënie të shkurtra e intensive por jo shumë të qëndrueshme, të zhytur në një mjedis të rrjedhshëm e të ndryshueshëm që mund të ushqejë në ta forma të ndryshme pasigurie dhe paqëndrueshmërie në zgjedhjet më të rëndësishme, duke u gjendur nganjëherë në vështirësi të mëdha, nëse jo duke u ndier madje të paaftë për të përpunuar momente krize dhe dyshimi në lidhje me zgjedhjen e tyre thirrrore. Gjithashtu, është vënë re njëfarë prirjeje nga ana e fretërve të rinj që të parapëlqejnë qendrat e mëdha urbane në vend të misionit në zonat e varfra dhe periferike.







78. “Njeriu, kur hesht, shqyrton rrugët e tij dhe ka mundësi të shohë se sa e madhe është pamjaftueshmëria e tij dhe sa i vogël përparimi i tij” (*Jeta e përkryer e motrave IV, 3*).

79. “Sikurse miku është i lumtur të dëgjojë atë që thuhet në lidhje me mikun e vet dhe i sëmuri është i lumtur të dëgjojë këshillat e mjekut, po ashtu ai që e do Hyjin është i lumtur të dëgjojë Fjalët e Hyjit” (*Sermone 46. Transferimi i shën Françeskut*).

80. “I lumi Françesk mundi të thoshte “mësoni prej meje sepse kam qenë një nxënës i vërtetë i Jezu Krishtit”, sepse nuk ka qenë një dëgjues i shkujdesur i Fjalës së Hyjit, por një njeri që e vë atë në jetë” (*Sermone 59. Mbi atin tonë të shenjtë shën Françeskun*).

81. “Françesku nuk ishte një dëgjues i shurdhër i Ungjillit” (*LegiM I, 1*).

82. “Çdo Shkrim është zemër e Hyjit, gojë e Atit, gjuhë e Birit, pendë e Shpirtit Shenjt. Ati flet nëpërmjet Fjalës apo gjuhës, por ai që e plotëson dhe ia beson kujtesës është penda e shkruarit dhe ky është Shpirti Shenjt” (*Përmbledhje mbi Hexaameronin XII, 17*).

83. “Hyji nuk flet vetëm nëpërmjet fjalëve, por edhe nëpërmjet veprave” (*Breviloquium, hyrje*).

### ***Dëgjimi dhe shoshitja në magjisterin e Papa Françeskut***

84. “U kushtojmë një kohë falas dhe pa nxitim vetëm gjërave apo personave që i duam; dhe këtu bëhet fjalë për të dashur Hyjin që ka dashur të flasë. Duke nisur prej kësaj dashurie, mund të rrimë gjithë kohën e nevojshme, me qëndrimin e nxënësit: «Fol, o Zot, se të dëgjon shërbëtori yt» (1 Sam 3,9)” (*EG 146*).

85. “Në këtë heshtje është e mundur të shoshiten, në dritën e Shpirtit, udhët e shenjtërisë që Zoti na propozon. Përndryshe, të gjitha vendimet tona do të mund të jenë vetëm “dekorime” që, në vend që ta lartësojnë Ungjillin në jetën tonë, do ta mbulojnë atë dhe do t’i marrin frymën. Për çdo nxënës është e domosdoshme të rrijë me Mësuesin, ta dëgjojë, të mësojë prej Tij, të mësojë





## FRETËRIT MINORË

### Në një botë që ndryshon me të shpejtë

**87.** Jetojmë në një ndryshim epokal të shkaktuar nga veprimi njerëzor mbi planetin. Në të vërtetë, jemi në një epokë në të cilën njerëzimi dhe planeti ndryshojnë shumë shpejt, siç paralajmëron papa Françesku në Enciklikën *Laudato si'*: “Megjithëse ndryshimi bën pjesë në dinamikën e sistemeve komplekse, shpejtësia që veprimet njerëzore i imponojnë sot është në kundërshtim me ngadalësinë e natyrshme të evolucionit biologjik” (krh. LS 18). Edhe shën Françesku ka jetuar ndryshime të mëdha në kohën e vet, sigurisht me të tjera ritme dhe me një vështrim antropologjik të ndryshëm, duke e konsideruar qenien njerëzore si “shëmbëlltëri dhe përngjasim të Krijuesit” (krh. RrP 23, 1-3; Qor 5,1) dhe duke e konsideruar atë unitar në “trup e shpirt” (krh. RrP 23,8).

**88.** Sikurse pjesa më e madhe e njerëzimit, edhe fretërit janë duke u angazhuar për të përparuar në shpejtimin e shndërrimit dhe të ndryshimit shoqëror (krh. LS 18). Kombinimi i një kompleksiteti të madh dhe i një ndryshimi të shpejtë bën që njerëzimi të gjendet i sulmuar nga një rrjedhshmëri dhe nga një pasiguri që nuk i ka përjetuar kurrë më parë. Këto ndryshime paraqesin aspekte si pozitive ashtu edhe negative, që megjithatë nuk hyjnë në kategori të ndara qartazi. Teknologjitë dhe zhvillimi ekonomik i bëjnë jetët tona më të rehatshme e të lidhura, ashtu siç krijojnë edhe mundësi për marrjen e njohurive dhe dialogun. Nga ana tjetër, po këto forca favorizojnë shekullarizimin, frikën, tjetërsimin, depresionin e masës, shfrytëzimin ekonomik e shoqëror dhe degradimin mjedisor.

**89.** Ne Fretërit minorë, në mes të kësaj pasigurie, pohojmë themelin tonë ungjillor dhe bashkimin me karizmën tonë françeskane e me vlerat françeskane si formë jete (krh. RrP 22; RrV 1; 2Test 14; KGJ 1,2). Vazhdojmë ta gjejmë Hyjin në këtë botë që ndryshon dhe jo vetëm ne, sepse jemi të rrethuar nga shumë mënyra të tjera për ta dëftuar dhe jetuar fenë tonë me rrjedhojë pasurimin dhe formimin e ndërsjellë. Kjo na kujtohet veçanërisht prej fretërve tanë me prejardhje nga Azia dhe nga Afrika. Kjo do të thotë se mund ta dëshmojmë edhe më shumë vlerën e karizmës sonë françeskane (krh. KGJ 83,1; 84; 87,2; 89).



duhet të kujdesemi gjithmonë, duke njohur atë që shën Françesku ka jetuar dhe u ka kërkuar Fretërve minorë (krh. LU 2; RrV 8; RrP 5; 18; 19; 2Test 27.33).

**94.** Neni i parë i Kushtetutave tona Gjenerale, duke paraqitur karakteristikat e një jete rrënjësisht ungjillore, pasi flet për shpirtin e uratës dhe devocionin, përmend thirrjen tonë në bashkimin vëllazëror. Kështu sqaron se bashkimi vëllazëror nuk është diçka fakultative, por një aspekt themelor, që vendoset vetëm pas qendërsisë së Hyjit. E pohon këtë edhe neni 38, që hap kapitullin III, të kushtuar jetës vëllazërore: “Fretërit, si bij të Atit qiellor dhe vëllezër të Jezu Krishtit në Shpirtin Shenjt, duke ndjekur formën ungjillore që Zoti i ka zbuluar shën Françeskut, bëjnë jetë vëllazërore në bashkësi, e duan dhe e ushqejnë njëri-tjetrin më shumë se sa një nënë e do dhe e ushqen birin e vet për nga mishi”.

**95.** Prandaj, jo vetëm si përgjigje ndaj situatave të ndryshueshme të botës sonë, që shpesh shkaktojnë vetmi e izolim, por, sidomos, duhet ta shqyrtojmë çdo ditë besnikërinë tonë ndaj këtij elementi thelbësor të *forma vitae* tonë, si përgjigje ndaj Zotit që “na ka dhënë disa vëllezër” dhe, me dhuratën e vëllezërve, vazhdon të na thërrasë në jetën ungjillore në vëllazëri.

**96.** Gjatë dialogut në KPU, disa grupe kanë këmbëngulur për t’i shtuar fjalën “soditëse” termit “vëllazëri”. Kjo për të nënvizuar qendërsinë e Hyjit në jetën tonë vëllazërore, ashtu siç thuhet edhe në Kushtetutat Gjenerale me shprehjen “në shpirt urate dhe devocion” (KGJ 1,2), që përbën elementin e parë të një jete rrënjësisht ungjillore (krh. 2Test 14-15), dimensionin e vetëm që vendoset para bashkimit vëllazëror. Kështu kuptohet se rrjedhoja e parë e bashkimit tonë me Hyjin e në Hyjin është bashkimi vëllazëror.

**97.** Disa vëllezër kanë pyetur veten se mos shekullarizimi, që ndikon në kulturën tonë në shumë krahe në të cilat gjendet Urdhri, është shumë i pranishëm edhe në ne e në vëllazëritë tona. Kujtojmë se, në Studimin mbi gjendjen e Urdhrit që ka përfunduar në vitin 2013 me mbështetjen e një studimi të bërë mbi 1500 vëllezër, te pyetja se çfarë ndikon më negativisht në shtytjen e jetës personale rregulltare, gati gjysma e të intervistuarve (40,8%) ka vënë në dukje kujdesin e pamjaftueshëm për lutjen personale. Në të njëjtin studim, kur kanë treguar zgjidhjet për rigjallërimin e Urdhrit, vëllezërit kanë propozuar, në radhë të parë, një kujdes më të madh për marrëdhëniet në vëllazëri (53,9%) dhe, në radhë të dytë, thellimin e cilësisë së jetës shpirtërore personale (41,5%) (krh.



karizmatik dhe thirrjes sonë për ungjillëzim në bashkësi, që është “dëshmia e parë dhe më e ndritshme e Ungjillit, dhe shenjë profetike e familjes së re njerëzore” (KGJ 87,2).

**103.** Nga ana tjetër, klerikalizmi është një mondanizim i ushtrimit të shërbesës meshtarake dhe shfaqet kur Kisha nuk konsiderohet një “mister” i hirit, por në terma sociologjikë apo politikë, dhe nuk është më “shërbimi” por “pushteti” ai që e modelon veprimtarinë shërbestare (ministeriale). Në këtë mënyrë klerikalizmi “e shuan pak nga pak zjarrin profetik të cilin e gjithë Kisha është e thirrur ta dëshmojë në zemrën e popujve të vet. Klerikalizmi harron se dukshmëria dhe sakramentaliteti i Kishës i përkasin gjithë popullit të Hyjit, dhe jo vetëm pak të zgjedhurve e të ndriçuarve” (Papa Françesku, *Letër drejtuar Kardinalit Marc Ouellet*, President i Komisionit Papnor për Amerikën Latine).

**104.** Të njëjtat rreziqe mund të përmenden për Urdhrin tonë dhe për misionin e tij, që, sipas vullnetit të vetë shën Françeskut, dallohet që prej fillesave të veta si një “vëllazëri” në të cilën të gjithë janë thjesht “vëllezër” dhe “minorë”, pa dallime, as parapëlqime në bazë të shërbesave, titujve akademikë apo parësive të hamendësuarra “kishtare”.

**105.** Mendësia klerikale shpesh është e lidhur me autoritarizmin dhe arrogancën, në kërkim të statusit dhe të vetadministrimit të parasë së marrë nëpërmjet punës. Në këtë mënyrë, klerikalizmi e dëmton jetën tonë vëllazërore dhe minore, duke errësuar kështu misionin tonë profetik.

## **Në marrëdhënie me të rinjtë**

**106.** Të rinjtë nxiten kështu prej papa Françeskut: “Mos kini frikë ta dëgjoni Shpirtin që ju sugjeron zgjedhje të guximshme, mos ngurroni kur ndërgjegjja ju kërkon të rrezikoni për të ndjekur Mësuesin. Edhe Kisha dëshiron të vihet në dëgjim të zërit tuaj, të ndjeshmërisë suaj, të fesë suaj; madje edhe të dyshimeve tuaja dhe të kritikave tuaja. Bëni që të dëgjohet britma juaj, lëreni të jehojë në bashkësitë dhe bëni që të arrijë tek barinjët. Shën Benedikti i porosiste abatët që të këshilloheshin edhe me të rinjtë para çdo zgjedhjeje të rëndësishme, sepse “shpesh pikërisht më të riut Zoti i zbulon zgjidhjen më të mirë” (*Rregulla e Shën Benediktit III, 3*)” (Letra e Papës drejtuar të rinjve me rastin e paraqitjes së *Dokumentit Përgatitor* të Asamblesë XV së Përgjithshme të Zakonshme të



Ky mjet lejon takimin personal me Jezusin që ndryshon jetën, nëpërmjet shembullit të shën Françeskut dhe propozimeve të tjera ungjillore të forta.

**112.** Fretërit janë të thirrur të lejojnë të sfidohen prej të rinjve të sotëm, që të mund të kuptojnë se kush janë të rinjtë, çfarë dëshirash dhe sythash jete të re bartin në vetvete dhe kështu t'i ndihmojnë në ecjen e tyre të rritjes njerëzore e shpirtërore. Duhet të fillojmë me një përshtirëri të takimit që hap ndaj një përshtirërie të sakramenteve. Nëse i dëgjojmë të rinjtë pa paragjykim, mund të hyjmë në botën e tyre dhe të mësojmë shumë prej tyre dhe prej vizionit të tyre të realitetit. Mund të ndihmojmë për një takim të thellë të të rinjve me shën Françeskun që çon edhe në zgjedhje rrënjësore e në zgjedhje jete ungjillore, duke i shoqëruar në ecjen e një njohjeje dhe bashkimi progresiv me Hyjin.

**113.** Duke iu referuar kujdesit për botën e krijuar, “të rinjtë kërkojnë prej nesh një ndryshim. Ata pyesin se si është e mundur që të pretendohet të ndërtohet një e ardhme më e mirë pa menduar për krizën mjedisore dhe për vuajtjet e të përjashtuarve” (LS 13). Gjithashtu, në shtetet që do të duhej të prodhonin ndryshime më të mëdha në lidhje me stilet konsumiste të jetës dhe që nuk respektojnë mjedisin, të rinjtë kanë një ndjeshmëri të re ekologjike dhe një shpirt bujar, aq sa disa prej tyre luftojnë në mënyrë të admirueshme për mbrojtjen dhe kujdesin e shtëpisë së përbashkët, ndërsa të tjerë që janë rritur në një kontekst konsumi shumë të lartë dhe mirëqenieje kanë vështirësi të mëdha për të marrë stile të reja jete. Prandaj na vë përballë ndryshimeve të rëndësishme që përfshijnë të gjithë dhe na hapin ndaj stileve të reja edukative (krh. LS 209).

## **Të thirrur prej Enciklikës *Laudato si'***

**114.** Për sa i përket angazhimit në kujdesin për botën e krijuar dhe promovimin e drejtësisë dhe të paqes, duhet të pranojmë se vetëpërmbajtja në stilin e jetës dhe ndjeshmëria për solidaritetin ekologjik e shoqëror janë shprehje përkatëse të karizmës françeskane.

**115.** Ne fretërit duhet të jemi një pikë referimi dhe një burim për Kishën e për shoqërinë për një ekologji të gjallë dhe integrale. Françesku i Asizit ka frymëzuar botën, përfshirë edhe papa Françeskun në Enciklikën *Laudato si'*, në drejtimin e një vëmendjeje më të madhe ndaj nënës tonë Tokë. Papa Françesku deklaroi se Shenjti është shembulli i shkëlqyer i ekologjisë integrale (krh. LS





gjithçka që na rrethon” (LS 216), prandaj papa Françesku na fton në “kthimin ekologjik” (krh. LS 216-221).

## **Të thirrur prej situatave të emigrantëve dhe refugjatëve**

**119.** Rritja aktuale e emigrimit njerëzor na bën thirrje. Si qenie njerëzore dhe si françeskanë, jemi thellësisht të prekur e të përfshirë prej shpresave, prej anktheve dhe prej vuajtjeve të shumë emigrantëve e refugjatëve. Sipas shembullit të Krishtit dhe në shpirtin e shën Françeskut, që na fton të jemi të gëzuar kur jetojmë “mes personash të parëndësishëm e të përbuzur, mes të varfërve e të dobtëve, mes të sëmurëve e të gërbulurve dhe mes lypsarëve përgjatë rrugës” (krh. RrP 9,2), e dimë se duhet t’i mirëpresim e pranojmë me mirësjellje e bujari.

**120.** Nga ana tjetër, si fretër minorë, *shtegtarë dhe të huaj në këtë botë*, jemi të thirrur jo vetëm që të refuzojmë çdo pronë personale (krh. RrV 6,1; KGJ 72), por edhe që me stilin tonë të jetës të jemi shenja të transhencës dhe dëshmitarë të plotësisë së të mirave që na janë dhuruar e që arrihen përtej kufijve të hapësirës dhe kohës. Në këtë mënyrë, forma jonë e jetës pohon se atdheu ynë i vërtetë e përfundimtar gjendet përtej, se të mirat që tani i kemi nuk na përkasin, duke propozuar kështu marrëdhënie të reja me Hyjin, me të tjerët dhe me botën e krijuar.

**121.** Në këtë horizont kuptimi, të qenurit “minorë” do të thotë të braktisim çdo dëshirë për sundim, çdo qëndrim dhe formë mujsharie: “Ne nuk jemi Hyji. Toka na paraprin dhe na është dhënë. ... Si përfundim, «e Zotit është toka» (Ps 24,1), Atij i përket «toka dhe gjithçka është në të» (Lp 10,14). Prandaj Hyji mohon çdo pretendim për pronësi absolute: «Toka nuk mund të shitet për përgjithmonë, sepse është e imja, kurse ju jeni tek unë vetëm të ardhur e pendarë» (Lev 25,23)” (LS 67). Kështu kuptohet se vetëm duke e jetuar me njëmendësi minoritetin tonë, vetëm prej përjetimit të mirësisë së Hyjit, të vetmit pronar, të mirë e bujar, që ka krijuar gjithçka me dashuri, do të mund të ndihmojmë për të ndërtuar vëllazërinë e gjithmbarshme.

**122.** Ky vizion françeskan i jetës që gjen në zbulimin biblik themelet e veta, na bën të kuptojmë se një i vetëm është Ati ynë dhe se ne jemi të gjithë vëllazër (krh. RrP 22,34-35) dhe se jemi të bashkuar nga lidhje të padukshme me të

gjitha qeniet e gjithësisë dhe formojmë njëfarë familjeje të gjithmbarshme. Kjo na çon në një ndjenjë bashkimi me të gjitha qeniet e natyrës, veçanërisht na mbush me dashuri, dhembshuri e shqetësim për qeniet e tjera njerëzore dhe na nxit në një angazhim të vazhdueshëm për problemet e shoqërisë (krh. LS 89; 91): “Gjithçka është në marrëdhënie dhe të gjithë ne qeniet njerëzore jemi të bashkuar si vëllezër e motra në një shtegtim të mrekullueshëm, të lidhur prej dashurisë që Hyji ka për secilën prej krijesave të veta dhe që na bashkon edhe mes nesh, me një dashuri të ëmbël, me vëllain diell, me motrën hënë, me vëllain lumë e me nënën tokë” (LS 92).

**123.** Prandaj, nuk mund të mbetemi mospërfillës ndaj krizës së rëndë të lëvizshmërisë njerëzore, nuk mund të jemi mospërfillës ndaj situatës së vëllezërve tanë emigrantë.

**124.** Fretërit janë duke punuar me bashkësi emigrantësh dhe/ose refugjatësh në të gjithë botën, madje, jemi një rrjet global në shërbim të emigrantëve në vendet e prejardhjes dhe të pikëmbërritjes. Mundemi ende ta fuqizojmë bashkëpunimin me Familjen Françeskane dhe organizata të tjera (krh. KGJ 88). Duam t’i përdorim strukturat tona në të dy skajet e rrugëtimit të emigrantëve. Do të mund të jemi në gjendje të ndihmojmë emigrantët e mundshëm që t’i kuptojnë më mirë rreziqet e udhëtimit dhe pritshmëritë jo realiste që disa emigrantë kanë në lidhje me kushtet kur arrijnë në pikëmbërritjet e tyre. Në disa raste, do të mund të jemi në gjendje të ndihmojmë për të lehtësuar kthimin e emigrantëve, por në raste të tjera, sikurse në rastin e viktimave të tregtisë së qenieve njerëzore, nevojitet një strategji për integrimin. Disa Konferenca janë duke bashkëpunuar për të krijuar një rrjet sigurie dhe mbështetjeje në të dy skajet e rrugëtimit të emigrimit apo përgjatë të njëjtit rrugëtim. Kjo mund të përsëritet në Konferenca të tjera apo mes Konferencave.

## **Në botë si mjete të paqes**

**125.** Dhuna vazhdon ta godasë njerëzimin, veçanërisht atë më të varfër, por me modalitete të reja. Dhuna bashkëkohore merr formën e dhunës shtëpiake, të dhunës gjinore, të dhunës politike e fetare, si dhe të asaj ekonomike ndaj të varfërve. Është duke u përhapur si keqpërdorim i nënës Tokë (krh. KK) dhe i sistemit tonë klimatik. Shfaqet në bandat kriminale dhe në retorikën politike të nacionalizmave, përveçse në luftërat reale, në armatimet, në narkotrafikun, në

terrorizmin, në tregtinë e personave, në mjetet e dhunshme të komunikimit (filma etj.), në dhunimet e bëra nëpërmjet internetit dhe në korrupsion. Papa Françesku flet për “mbrapshtinë” si krijuese të dhunës prej mungesës së mundësisë së rritjes për të gjitha vendet (krh. EG 59-60), duke treguar se, për të përballuar dhunën, është e nevojshme të nxitet një ekonomi më e drejtë dhe e tejdukshme në nivel global (krh. Is 32,17).

**126.** Jezusi i ka mbrojtur personat nga dhuna (krh. Gjn 8,1-7) dhe u ka paraqitur horizonte paqeje e harmonie nxënësve të vet (krh. Mt 20,25-26). Duke iu referuar Krishtit, shën Pali pohon se ai “është paqja jonë” (krh. Ef 2,14), ai që ka “vendosur paqen me anë të gjakut të kryqit të tij” (krh. Kol 1,20). Ecja drejt paqes realizohet pra brenda nesh, në takimin me Krishtin dhe kthimin personal, dhe përjashta në vëllazëritë tona dhe në botë nëpërmjet përpjekjes për ndërtimin e marrëdhënieve të bazuara në bashkimin e në paqen. Në situata të ndryshme sakramenti i pajtimit mund të jetë burim paqeje e ndryshimi për një jetë më në përputhje me Ungjillin.

**127.** Të gjithë të krishterët janë të thirrur në paqen që realizohet dhe ndërtohet edhe në kryerjen e misionit për t’u kujdesur për të varfrit dhe të vuajturit, siç ka kërkuar vetë Jezusi (krh. Lk 4,16-21; Mt 25,31-46; Gjn 10; Lk 15) dhe siç ka realizuar menjëherë Kisha e fillimeve (krh. Heb 13,3).

**128.** Shën Françesku ka vendosur të predikojë pendesën dhe paqen. Në Rregullën e pavulosur porosiste: “O fretër të gjithë, të reflektojmë me vëmendje se Zoti thotë: Duajini armiqtë tuaj dhe bëjuni mirë atyre që ju urrejnë” (RrP 22,1). Gjithashtu, porositi që përshëndetja e fretërve të jetë urim paqeje (krh. RrV 3; RrP 14; 2Test 23) dhe që fretërit minorë të jenë paqësorë e bartës të paqes (Qor 13; 15; KK 11; RrP 17,15). Me jetën e vet ka qenë njeri i paqes dhe e ka nxitur e ndërtuar atë në raste të ndryshme sikurse në takimin me Sulltanin (krh. 1Cel 20,57) dhe “urën” e paqes në Gubio (krh. Lul 21) e në Asizi (krh. LegjPer 84). Gjesti i shkuarjes në takim me Sulltanin është simboli i shkëlqyer i dialogut dhe i takimit të paqes mes kulturave dhe besimeve.

**129.** Papa Françesku, kur flet për ekologjinë integrale, i referohet të mirës së përbashkët të nevojshme që “kërkon paqen shoqërore, do të thotë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e një rendi të caktuar, që nuk realizohet pa një vëmendje të veçantë ndaj drejtësisë shpërndarëse, cenimi i së cilës shkakton gjithmonë dhunë” dhe që “e gjithë shoqëria ka detyrën të mbrojë e të nxisë të

mirën e përbashkët” (LS 157). Pastaj kujton atë që papa Pali VI kishte përfshirë në *Populorum Progressio*: paqja “nuk kufizohet në një mungesë lufte, si fryt i një ekuilibri të dyshimtë pushteti. Ajo ndërtohet ditë për ditë, në ndjekjen e një rendi të dashur prej Hyjit, që bart me vete një drejtësi më të përsosur mes njerëzve” (krh. EG 219). Dhe përsëri dëshiron që katolikët të jenë ndërtues të paqes si artizanë: Jezusi na ka thënë: ‘Lum pajtuesit’ (Mt 5,9). Në këtë angazhim, edhe mes nesh, realizohet profecia e lashtë: ‘shpatat e veta do t’i kthejnë në plore e heshtat në drapërinj’ (Is 2,4)” (krh. EG 244).

## **Rregulltarë me vizionin e Kishës të papës Françesku**

**130.** Këshilli Plenar i Urdhrit tonë ka dashur të jetë një rast i privilegjuar për të dëgjuar atë që Shpirti u thotë fretërve minorë sot. Duke ndjekur këtë dinamikë, që prej paraqitjes së relacioneve të delegatëve të Konferencave dhe pastaj në dialogun e lehtësuar në grupet, qoftë për të shqyrtuar realitetet e paraqitura qoftë për të shoshitur atë që Zoti donte të na thoshte, pjesëmarrësit në KPU kanë gjetur një pikë takimi në frymëzimin dhe në sfidën që personi dhe shërbesa e papa Françeskut përbën për fretërit minorë sot.

**131.** Me zgjedhjen e emrit të vet, papa Françesku na frymëzon dhe na sfidon, që në fillim të pontifikatit të vet. Në të vërtetë, pak ditë pas zgjedhjes së tij ka treguar se e ka zgjedhur emrin e vet për arsye të shën Françeskut të Asizit, sepse ai emër i kujtonte të varfrit dhe ai donte ta drejtonte vëmendjen e vet nga më të dobëtit, nga të fundit e shoqërisë. Për papa Françeskun shën Françesku është njeriu i varfërisë, i paqes dhe i dashurisë për botën e krijuar.

**132.** Në këtë mënyrë, Papa na frymëzon të përtërijmë thirrjen e karizmën tonë dhe të konfirmojmë angazhimin tonë të jetës sipas shembullit të shën Françeskut, duke konfirmuar aktualitetin e vlerave françeskane dhe të jetës rregulltare karakteristike françeskane. Ai na thërret ta vëmë Jezusin në qendërën e jetëve tona, të krijojmë një kulturë të mëshirës e të takimit, dhe të dalim me gëzim në periferitë për të ndenjur me të varfrit. Në Nxitjen *Evangelii Gaudium* pohon se “një shenjë e qartë e vërtetësisë së një karizme është pjesëmarrja në Kishë që është aftësia e saj për t’u integruar në mënyrë të harmonishme në jetën e Popullit të shenjtë të Hyjit për të mirën e të gjithëve” (EG 130).

**133.** Papa Françesku na sfidon si fretër minorë që të shkojmë në thellësi të identitetit tonë françeskan, duke e jetuar minoritetin në vëllazëri dhe në shërbim ndaj Popullit të Hyjit. Le të kujtojmë se përveç marrjes së emrit Françesk, mes zgjedhjeve të tij të para ka qenë refuzimi i çfarëdo simboli pushteti dhe mburrjeje të kotë. Ka dëshiruar të vazhdojë të mbajë kryqin e vet prej hekuri, të zhvendoset nëpër Romë me një makinë të zakonshme, të banojë në Shtëpinë Shën Marta, hotel ku ka banuar gjatë konklavës. Ka shpallur një jubile të kushtuar mëshirës; ka folur me guxim dhe shpesh për mëkatin e klerikalizmit; shpesh u ka bërë thirrje Kishës dhe rregulltarëve në lidhje me nevojën e ngutshme për të shkuar e për t'u dalë përpara nevojtarëve; ka caktuar një ditë botërore vjetore të të varfërve; ka shkruar një enciklikë për kujdesin ndaj botës së krijuar, duke e filluar me fjalët e para të Këngës së Krijesave: *Laudato si'*.

**134.** Prandaj papa Françesku na sfidon dhe nxit të rrezikojmë. Shembulli i tij dhe mësimet e tij na nxisin ta jetojmë me njëmendësi minoritetin tonë, t'u hapemi të gjithëve për të bashkëndarë idealin e një vëllazërie që është me të vërtetë e gjithmbarshme. Në këtë mënyrë na fton në shqyrtimin e provincializmave tanë, strukturave tona të drejtimit dhe të formës e të modeleve të jetës sonë rregulltare.

**135.** Vizioni i tij për jetën rregulltare është një vizion që përfshin profecinë, itinerancën, qendërsinë e Krishtit, nxitjen e bashkimit vëllazëror mes nesh, me njerëzit e me mjedisin, veçanërisht me të varfrit. Në fjalimin e vet drejtuar fretërve të Kapitullit më 26 maj 2015, ka theksuar dy elementet thelbësore të identitetit tonë: minoritetin dhe vëllazërinë. Për të “minoritet do të thotë edhe të dalësh prej vetvetes, prej skemave dhe këndvështrimeve personale; do të thotë të shkosh përtej strukturave, të shkosh përtej zakoneve e sigurive, për të dëshmuar një afërsi konkrete me të varfrit, me nevojtarët, me të mënjanuarit e shoqërisë, në një qëndrim të njëmendtë bashkëndarjeje dhe shërbimi”.

PJESA III

**DALJA**



**136.** Këshilltarët e mbledhur në KPU, pasi kanë dëgjuar përshkrimet e situatave dhe të zgjedhjeve që karakterizojnë realitetet e ndryshme në të cilat gjenden fretërit minorë në botë dhe pasi kanë diskutuar në grupet e punës, kanë shprehur sugjerime të ndryshme në mënyrë që Urdhri ynë dhe çdo bashkëvëlla të mund të gjejë në to një ndihmë për një bashkim të përtërirë me thirrjen françeskane, duke e mishëruar atë në botën e sotme që është në një ndryshim kaq të shpejtë.

## SI FRETËR MINORË

### **Në një botë që ndryshon me të shpejtë**

**137.** Nëpërmjet vëllazërisë sonë në mision, si nxënës të Krishtit dhe bij të shën Françeskut, të ndriçuar prej fjalëve të Ungjillit, duam ta ndihmojmë në mënyrë aktive e krijuese këtë botë që është duke ndryshuar kaq shpejt. Mund të fillojmë duke u nisur nga disa pyetje që kanë dalë në diskutimet në asamble dhe që mund t'ia shtrojmë vetes në çdo vëllazëri tonën: Çfarë është duke ndryshuar? Çfarë është duke na ndryshuar ne? Çfarë jemi duke ndryshuar ne? Si i paraqesim teologjinë dhe ekleziologjinë? Çfarë përmbajtjesh ka në predikimin tonë?

**138.** Dëshirojmë të ofrojmë rrugë të reja për të përfshirë shoqërinë dhe të varfrit; të ofrojmë gjuhë të reja për të folur për Hyjin në kontekstin e kësaj tronditjeje shoqërore, dhe kështu të mund të vazhdojmë të dëshmojmë vlerat e Ungjillit dhe karizmën françeskane. Duam të shtojmë e të thellojmë dialogun, si dhe të nxisim e të kujdesemi për dëgjimin e përhershëm nga ana e ne fretërve minorë, si brenda ashtu edhe jashtë bashkësive tona.

**139.** Kulturat janë duke ndryshuar, me drita e hije të ndryshme. Gjatë Këshillit Plenar ka dalë në pah pyetja: a janë duke ndryshuar qeniet njerëzore apo është kuptimi ynë i natyrës njerëzore ai që ndryshon? Ndoshta ndryshimi në njerëzimin është i rastësishëm dhe jo thelbësor. Për t'iu përgjigjur pyetjeve kaq të rëndësishme e komplekse, do të jetë themelore të ndihmohemi prej ekspertëve dhe prej vëllezërve kompetentë për të pasur mjete që ndriçojnë dhe shoqërojnë shoshitjen në vëllazëri.



## **Si vëllazëri soditëse në mision**

**140.** Përveç reflektimit në lidhje me thirrjen tonë për të qenë vëllazëri soditëse në mision, gjatë KPU-së janë bërë edhe propozime konkrete për vëllazërit tanë dhe Entitetet e ndryshme. Ja këtu më poshtë disa prej atyre më të rëndësishmeve.

**141.** Prandaj çdo Entitet dhe vëllazëri është e ftuar në një lexim apo analizë të realitetit dhe të kontekstit në të cilin është e përfshirë dhe ushtron misionin e vet, për të njohur shenjat e kohëve në dritën e Ungjillit, të karizmës sonë dhe të doktrinës shoqërore të Kishës, për të aktualizuar pastaj formën e jetës françeskane në realitetin në të cilin jeton.

**142.** Çdo vëllazëri dhe çdo vëlla duhet para së gjithash ta vendosë këtë realitet para Hyjit në lutje. Të gjitha vëllazëritë dhe të gjithë vëllezërit, pra, janë të ftuar të jetojnë kohën e lutjes, si atë bashkësiore ashtu edhe atë personale, në lidhje dhe në përpjesëtim me kohën e përdorur për ungjillëzimin.

**143.** Edhe tema e individualizimit do të mund të përballohet në programet e formimit të përhershëm dhe fillestar, në mënyrë që të nxitet një stil vëllazëror dhe bashkëpunimi të ndërsjellë në marrjen përsipër dhe në të jetuarit e shërbimeve baritore.

**144.** Mund të nxitet ungjillëzimi edhe nëpërmjet vëllazërive ndërkombëtare në mënyrë që të favorizohet takimi dhe integrimi i ndryshimeve, duke dhënë, nëpërmjet bashkëpunimit vëllazëror, një dëshmi françeskane të stilit tonë të jetës dhe të veprimit.

**145.** Secili Entitet mund të bëjë një shqyrtim të angazhimeve të veta shërbestare institucionale, për të favorizuar sa më shumë stilet e bashkëpunimit vëllazëror dhe shërbimit, duke shmangur qëndrime klerikale mes vëllezërve.

**146.** Duke iu referuar përfshirjes në një pjesëmarrje të plotë të vëllezërve laikë në jetën dhe në misionin e vëllazërisë, çdo Entitet është i ftuar të aktivizojë strategji dhe modalitete që favorizojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e tyre të plotë në nivelet e ndryshme.

**147.** Është mirë të hartohen mirë programet e formimit për guardianët dhe formuesit, duke përfshirë formimin njerëzor, sidomos për sa i përket dialogut dhe komunikimit ndërpersonal, të punuarit dhe të projektuarit së bashku në mënyrë efikase.

**148.** Theksohet rëndësia e përpunimit të Projektit të jetës vëllazërore dhe të misionit, në mënyrë që të gjithë fretërit të jenë të përfshirë në veprimtaritë e ndryshme, në një projektualitet që mban parasysh dimensionet e ndryshme të vëllazërisë, duke favorizuar aftësitë dhe burimet e secilit dhe të bashkësisë në tërësinë e vet. Në projekt duhet të konsiderohet me vëmendje perspektiva e misionit përkatës në kontekstin në të cilin secila bashkësi jeton, duke krijuar kushtet që fretërit ta vendosin jetën vëllazërore si qendër shtytëse të veprimtarisë baritore.

## **Në marrëdhënie me të rinjtë**

**149.** Shumë fretër janë të angazhuar në ungjillëzimin dhe në katekezën drejtuar të rinjve, dhe përdorin gjuhë të ndryshme si për shembull artin, muzikën, kulturën dhe nëpërmjet temave sikurse kujdesi për botën e krijuar. Shumë tema të tjera mund të propozohen, veçanërisht në dritën e *Laudato si'*. Të hyjmë në kontakt dhe në dialog me të rinjtë do të thotë të përdorim gjuhë dhe kategori komunikative që arrijnë tek ata edhe brenda botës digjitale të mediave sociale, për t'i ftuar dhe për t'i përfshirë që të marrin pjesë konkretisht në jetën kishtarë, me propozime të forta ungjillore, si në fushën shpirtërore ashtu edhe në atë të shërbimit, duke i dhënë gëzim e domethënie jetës së tyre.

**150.** Në të njëjtën kohë, të rinjtë janë shumë të ndërlidhur dhe frymëzohen nëpërmjet kontakteve që kanë (sado sipërfaqësore) me personat e kulturave, vendeve dhe kontinenteve të tjera. Shpesh dinë më shumë se sa të moshuarit për ngjarjet në vende të tjera. Si mund ta përdorim sa më mirë networking-un digjital dhe mediat sociale për të nxitur një angazhim të thellë, jo sipërfaqësor, me Hyjin dhe me realitetin? Mund dhe duhet ta bëjmë këtë me pjesëmarrjen aktive dhe zërin e të rinjve, duke shkuar drejt të rinjve me të rinjtë. Entitetet në Urdhër mund të thërrasin grupe të rinjsh dhe të rinj të rritur për t'u dhënë bashkëpunim e ndihmë fretërve në lidhje me atë se si të ecin e të veprojnë në këtë fushë.

**151.** Fretërit dëshirojnë të jenë të hapur ndaj të rinjve, për t'i dëgjuar dhe për t'i shoqëruar në mënyrë të njëmendtë dhe integrale. Dëshirojmë t'u afrohemi atyre dhe t'i pranojmë pa paragjykim. Duam t'i duam me zemër të lirë, për të mirën e tyre, dhe jo për t'i tërhequr nga vetja, por për t'i çuar në takimin personal me Atin, Birin dhe Shpirtin Shenjt. Duam të tregojmë arsyet e gëzimit tonë dhe të ofrojmë vlerat e jetës dhe misionit tonë. Në çdo vëllazëri është themelore që të ketë momente lutjeje me të rinjtë, edhe ekumenike dhe ndërfaqetare. Gjithashtu, i rëndësishëm konsiderohet formimi i fretërve për të ndërtuar ura ndërbreznore.

**152.** Fretërit përpiqen të ndryshojnë apo të përshtasin mënyrën e jetesës françeskane në mënyrë që të mund të jetë e rëndësishme për kulturën dhe botën e të rinjve. Vlerat françeskane qendrore janë të pandryshueshme, por modalitetet për t'i jetuar dhe dëshmuar ato munden dhe nganjëherë duhet të ndryshohen. Si mund të rritemi në dijen për të bërë dallim mes asaj që është thelbësore (e duhet të ruhet) dhe asaj që është e përpunueshme në mënyrën tonë të të jetuarit?

**153.** Vëllazërit tanë guardianë mund ta çojnë këtë temë në kapitujt e vëllazërive duke na pyetur për shembull: si vëllazëri, *si mund të jemi të hapur ndaj të rinjve?* Meqenëse shtëpitë tona janë të thirrura të jenë të hapura ndaj të rinjve në mënyrë që ata të mund të eksperimentojnë formën tonë të jetës ungjillore dhe t'i hapen takimit me Hyjin. Nga ana tjetër, është urgjente që të gjitha pranitë tona të ofrojnë një mjedis mikpritës për fretërit e rinj. Shtëpitë tona të formimit mund të përfshijnë me qëllim fretër më të moshuar dhe kjo mund t'i japë mundësi një përvojë formimi të ndërsjellë dhe ndërbreznor. Po këto vëmendje të shprehura prej fretërve për të rinjtë vlejné edhe në përgjithësi për aspirantët dhe fretërit e rinj.

## **Të angazhuar me Enciklikën *Laudato si'***

**154.** Si individë, vëllazëri, Entitete dhe si Urdhër ndërkombëtar, ndihemi shumë të thirrur për të bërë një zgjedhje të qartë e rrënjësore në drejtimin e modaliteteve të jetës të treguara nga *Laudato si'*. Për të qenë një far i shpresës ekologjike, jemi të thirrur në një zgjedhje rrënjësore për ta jetuar njëmendësisht karizmën tonë dhe për të ndërmarrë një ecje kthimi ekologjik (krh. LS 5; 216-221). E propozojmë këtë për Kapitullin e ardhshëm Gjeneral si një prej temave

që të mund t'i komunikojmë gjithë botës një vizion françeskan shprese ekologjike për të gjithë.

**155.** Duam të angazhohemi në formimin e fretërve me mjete të lehta e të shpejta të bazuara në vlerat françeskane (si për shembull: “rrugëtimi ekologjik” i realizuar në Francë, video tutorial në sitin web OFM etj.) veçanërisht në perspektivën e një “ekologjie njerëzore”. Do të ishte e dëshirueshme që dokumenti *Laudato si'* të përkthehej në linja udhërrëfyese për jetën e fretërve dhe për predikimin.

**156.** Kemi Zyrën DPIK për animimin e fretërve, por do të ishte mirë të nisnin kurse edhe në qendrat e studimit të Urdhrit, për të formuar persona brenda dhe jashtë Urdhrit. Kjo a do të mund të bëhej në nivel françeskan ndër-dëgjesor? A do të mund të bëhej Universiteti Papnor Antonianum udhëheqës botëror në këtë lëndë? Çdo Entitet i Urdhrit pastaj do të duhej të përfshinte në formimin fillestar dhe të përhershëm temën e ungjillëzimit në shpirtin e *Laudato si'* me një theks të veçantë në ekologjinë njerëzore.

**157.** Fretërit minorë dëshirojnë ta realizojnë vizionin e *Laudato si'* nëpërmjet network-eve dhe bashkëpunimit me grupe, organizata, specialistë dhe lëvizje shoqërore. Megjithëse trashëgimia e pasur e traditës dhe përshtetërisë sonë françeskane na lejon të japim një ndihmesë të pasur për dialogun, ka edhe organizata të tjera që punojnë në këtë fushë, në dëgjim të të cilave mund të vendosemi, prej të cilave mund të mësojmë shumë dhe me të cilat mund të bashkohemi për të bashkëpunuar në projekte të përbashkëta.

**158.** Gjithashtu, *Laudato si'* kërkon dialog më të madh në nivel shkencor, ekumenik dhe ndërjetar. A mundën fretërit të paraqesin një platformë për një dialog mbi *Laudato si'*, duke krijuar një vend takimi? Si mund të hyjmë në bashkëpunim për të nxitur një përhapje më efektive të shpirtit të *Laudato si'*?

**159.** Duam të drejtohem veçanërisht nga të rinjtë, sepse ata janë të drejtuar nga e ardhmja, janë më të aftë për ndryshim dhe janë më të hapur ndaj mësimi kateketik të *Laudato si'*. Është e rëndësishme që të japim ndihmesën tonë për ta kthyer *Laudato si'* nga një enciklikë në udhëzime jete dhe predikimi, nga një dokument i shkruar në një dokument të jetuar. Si mund t'i përfshijmë fretërit që të ndërmarrin një formim për sa i përket kësaj?

## Të angazhuar me vëllezërit emigrantë dhe refugjatë

**160.** Përveç reflektimit mbi migrimin njerëzor e qëndrimet tona dhe bashkëndarjes në lidhje me projekte konkrete tashmë në zbatim, gjatë KPU-së janë bërë propozime të mëtejshme konkrete për vëllezërit tanë dhe Entitetet e ndryshme. Ja këtu më poshtë çka ka dalë në pah.

**161.** Fretërit do të donin të nisnin një reflektim teologjik të bashkëndarë në lidhje me emigrimin, në bazë të të cilit të formulojnë programe formimi fillestar e të përhershëm për një përshtirje mirëpritjeje të emigrantëve. Si pjesë e këtij formimi, dhe për thirrjen tonë në minoritet, varfëri dhe itinerancë, mendohet se është e nevojshme të kemi vende dhe raste konkrete takimi me emigrantët. Duhet të pranojmë se disa fretër janë mjaft të largët nga emigrantët, të tjerë janë të frikësuar, të tjerë të fiksuar nga perspektiva e sigurisë. Në përpunimin e këtyre programeve të formimit, përveç Sekretariatit për Formimin dhe Studimet, mund të përfshihet edhe Sekretariati për Misionet dhe Ungjillëzimin, në bashkëpunim me zyrën e DPIK-ut dhe Franciscans International.

**162.** Pranohet se është e nevojshme t'u jepet një formim dhe një kualifikim profesional fretërve që janë më të përfshirë në këtë fushë. Gjithashtu, do të ishte e dobishme të krijoheshin disa forume ku mund të paraqiten ide dhe shembuj përgjigjesh ndaj kësaj problematike, dhe në të cilët fretërit të mund të marrin pjesë, duke bashkëndarë ide, propozime dhe projekte që vijnë nga kontinentet e ndryshme. Kjo mund të prodhojë një seri nismash më të gjera mes fretërve, me një përfshirje në nivele të ndryshme si *ad intra* ashtu edhe *ad extra*.

**163.** Duke mbajtur parasysh se shpesh mediat bashkëkohore e shtrembërojnë në mënyrë tragjike realitetin e emigrimit global, duke tjetërsuar informacionet me paragjykime nacionaliste e raciste, së bashku me një reflektim të saktë teologjik françeskan, është e nevojshme të thellohet një analizë shoqërore e dukurisë së emigrantëve, për të frymëzuar e për t'i dhënë qëndrueshmëri angazhimit tonë dhe veprimeve tona. Mund të zhvillohet një proces si ai i KPU-së për ta kuptuar më mirë këtë realitet, me ide dhe përgjigje shembullore të bashkëndara mes Konferencave dhe me krejt Urdhrin.

**164.** Ky studim i dukurisë emigruese duhet të mbajë parasysh karakteristikat që ajo ka në secilën zonë, motivimet e saj, rreziqet dhe mundësitë e saj. Duhet t'i kushtohet vëmendje edhe migrimit të brendshëm në shtete, si edhe problemit

të tregtisë së personave. Në të vërtetë, e dimë mirë se brenda flukseve migruese mund të ketë tregti njerëzish dhe organizata kriminale që favorizojnë migrimet për interesa ekonomike.

**165.** Është e nevojshme të bashkëpunojmë me institucione të tjera për të dhënë formim, kit burimesh dhe mbështetje. Fretërit a do të mund të zhvillojnë një organizim në gjendje t'u japin përgjigje të menjëhershme emergjencave? A do të mund të ketë një program formimi profesional për të ndihmuar fretërit që të përgjigjen në mënyrë efikase?

**166.** Si vëllezër, nuk duhet vetëm t'u shërbejmë emigrantëve por edhe, aty ku është e mundur, të ofrojmë hapësira mirëpritjeje në kuvendet tona dhe në jetën tonë vëllazërore, gjithmonë duke mbikëqyrur atë që është e nevojshme për jetën tonë të kushtuar. Duam të bëjmë gjithçka që është në mundësitë tona për t'i ndihmuar që të integrohen në shoqëritë e reja, për t'u dhënë atyre qasje në pasuritë dhe shërbimet, për t'i përkrahur që të kenë një shtëpi në mjediset e tyre të reja të jetës. Është qëllimi ynë të punojmë në famullitë dhe me institucionet lokale për t'i ndihmuar që të gjejnë strehim, ushqim, arsimim dhe punë. Prandaj mendojmë se duhet të bashkëpunojmë me strukturat e pranishme në territor. Së fundi, kemi mundësinë ta përbalim këtë mision si një Urdhër ndërkombëtar duke aktivizuar burime të shumta të cilat i kemi.

**167.** E dimë mirë se personat i lënë shtetet e tyre të prejardhjes për shumë arsye, mes të cilave ikja nga dhuna, nga përndjekjet politike, nga format moderne të skllavërisë dhe në kërkim të një jete më të mirë për vetveten dhe për familjet e tyre. Ndërkohë pranojmë se duhet të ruajmë një vështrim kritik mbi dukurinë emigruese, sepse ajo përfshin edhe tregtinë e njerëzve dhe forma të tjera të organizimit kriminal që shfrytëzojnë lëvizjet emigruese dhe i nxisin ato.

## **Në botë si mjete të paqes**

**168.** Besnikë ndaj karizmës sonë dhe historisë sonë të madhe si pajtues, ne fretërit minorë dëshirojmë të veprojmë për të qenë mjete të paqes e të pajtimit, duke vazhduar të jemi të pranishëm në vendet e luftës dhe të dhunës, për të mos i braktisur ata që vuajnë. Kemi nevojë t'i mbështesim dhe t'u japim formim specifik vëllezërve që duan të veprojnë në këto vende. Nuk mendojmë edhe aq për praninë e fretërve individualisht, por për vëllazëri soditëse në mision që të

jenë prani ndërtuese të paqes, shenjë e përvuajtur dhe e fortë e asaj paqeje që Hyji do për gjithë njerëzimin.

**169.** Fretërit minorë dëshirojnë të bëhen bartës dhe ndërtues të paqes. Prandaj kemi nevojë për formim në fushën e jo-dhunës aktive, me përvoja dhe institucione që mund të na ndihmojnë të bëhemi mjete paqeje gjithnjë e më efikase. Ky është parakushti për të pranuar, ndërtuar dhe përhapur paqen.

**170.** Për të nxitur një përrshpirtëri dhe një kulturë të paqes e të jo-dhunës, ne duam të lidhemi me rrjetet ekzistuese dhe të angazhuara, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, në dobi të paqes, të drejtësisë, të zhvillimit e të nxitjes njerëzore. Dëshirojmë të mësojmë prej përvojës së vëllezërve tanë në Tokën e Shenjtë, Sudanin e Jugut, Siri, Mindanao (Filipine), El Salvador dhe vende të tjera në konflikt dhe të kuptojmë se si realisht mund të jemi një burim i rëndësishëm për procesin e paqes, aty ku jemi të pranishëm dhe veprojmë.

**171.** Në vëllazëritë tona është e nevojshme të zhvillojmë programe formimi ad intra për të bërë të dalë në pah e për të kapërcyer dhunën që kemi brenda nesh, në individin, në marrëdhëniet vëllazërore dhe në gjuhën. Propozohet të përdoret edhe material i përshtatshëm i prodhuar në Zyrën DPIK OFM.

**172.** Është mirë të na kujtohet të gjithëve ne Fretërve minorë angazhimi i kërkuar nga Kapitulli Gjeneral 2009: “Të nxisim jo-dhunën aktive në jetën tonë, me një vëmendje të veçantë për zgjidhjen e konflikteve; t’u kushtojmë vëmendje të veçantë të përjashtuarve të shoqërive tona, sipas situatës së secilit Entitet, duke u angazhuar posaçërisht për mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave njerëzore; të konsiderojmë dhe të nxisim përdorimin etik të burimeve ekonomike e natyrore në jetën e fretërve, në misionin e tyre dhe në shoqëri” (Përçues të dhuratës së Ungjillit, 43).

## **Me vizionin e Kishës të papës Françesku**

**173.** Para këtij frymëzimi dhe këtyre sfidave të paraqitura në numrat e mëparshëm, Këshilltarët kanë pyetur veten në mënyrën që vijon.

**174.** A mund të krijojmë udhë për t’iu përgjigjur në mënyrë krijuese këtyre sfidave që na vijnë si nga shën Françesku ashtu edhe nga papa Françesku?

**175.** Si mund t'i japim më shumë konkretësi “ekleziologjisë dhe etikës së mëshirës” të propozuar nga papa Françesku?

**176.** Dëshirojmë t'i jemi besnikë shpirtit të themeluesit tonë duke jetuar sot si fretër dhe minorë. Shën Françesku, në Testamentin e vet, na nxit të kujtojmë vazhdimisht thirrjen tonë për të qenë një vëllazëri soditëse në mision. Në çfarë mase shembulli mësimet e papës Françesku na ndihmojnë ta përtërijmë këtë kujtesë?

**177.** Dëshirojmë të ëndërrojmë dhe në të njëjtën kohë të jemi profetë të shpresës, të aftë të shpallim Ungjillin për ndërtimin e Mbretërisë, duke paditur dhe luftuar situatat konkrete të padrejtësisë e të dhunës në botën aktuale. Ky qëndrim do të na bëjë të japim shumë fryt si persona të kushtuar që jemi, sidomos duke na mbrojtur prej tundimit që mund ta bëjë të pafrytshme jetën tonë të kushtuar, ashtu siç e ka përkufizuar papa Françesku: *tundimi i mbijetesës* (krh. Predikimi i Atit të Shenjtë Françeskut, Bazilika Vatikanase, 2 shkurt 2017). Shqetësimi për “mbijetesën” na paralizon, na bën të druajtur, ngadalë dhe pa e vënë re, na mbyll në shtëpitë tona dhe në skemat tona. Duam të kemi një zemër soditëse, të aftë të shohim se si Hyji ecën rrugëve të qyteteve tona dhe të lagjeve tona, i pranishëm mes njerëzve dhe kudo, në të gjithë botën e krijuar.







dhe ai izolim i shkaktuar shpesh nga ftohtësia e ndërsjellë në marrëdhëniet vëllazërore.

**185.** E gjithë kjo e mbështetur dhe e krijuar nga një jetë më e gjallë lutjeje personale dhe bashkësiore.

**B.** Për sa u përket të rinjve, duam të konkretizojmë, në të gjitha vëllazëritë, të paktën një veprim mes atyre të propozuar në vijim.

**186.** Të përtërijmë mënyrën e të jetuarit dhe të komunikuarit të karizmës sonë që të jetë e kuptueshme dhe domethënëse për kulturën dhe jetën e të rinjve të sotëm; shtëpitë tona duhet të jenë të hapura ndaj të rinjve, për t'u lejuar atyre të përjetojnë formën tonë të jetës ungjillore dhe t'i hapen takimit me Hyjin.

**187.** Të jemi të hapur ndaj të rinjve, për t'i dëgjuar dhe për t'i shoqëruar ata në mënyrë të njëmendtë dhe të përzemërt; t'u afrohen atyre, t'i pranojnë pa paragjykim; t'i duan falas, për të mirën e tyre; t'u ofrojnë atyre vlerat e jetës dhe misionit tonë.

**188.** Në ungjillëzim dhe në katekezë të përdorim artin, kulturën dhe natyrën në dritën e *Laudato si'*; të përdorim mjetet e teknologjive të reja, për t'i ftuar të rinjtë të marrin pjesë më thellësisht në botën reale, për t'i përfshirë ata në realitetin e të varfërve, të Kishës dhe të Hyjit në mënyrë më konkrete dhe të mishëruar; të krijojmë mundësinë që të krijohen lidhje me persona të kulturave, vendeve dhe kontinenteve të tjera.

**C.** Për sa i përket kujdesit për “shtëpinë e përbashkët”, në të gjitha vëllazëritë, duam të realizojmë të paktën një prej propozimeve që vijojnë.

**189.** Si individë, vëllazëri, Entitete dhe si Urdhër ndërkombëtar, të bëjmë një përzgjedhje të qartë e rrënjësore mbi modalitetet e jetës të treguara nga *Laudato si'*, për ta jetuar njëmendësisht karizmën tonë dhe për të ndërmarrë një ecje kthimi ekologjik (krh. LS 5; 216-221).



- mund të përdorim një rrugëtim tjetër që na këshillon të mos nisemi prej problemeve, por prej të dhënave e fakteve pozitive të pranishme në Entitetet dhe në vëllazëritë, që pastaj të formulojmë disa objektiva që i japin cilësi ecjes vëllazërore, të projektojmë ndërhyrje dhe t'i realizojmë ato (krh. “Appreciative Inquiry”).

Secili prej këtyre rrugëtimeve parashikon shkëmbimin dhe ballafaqimin vëllazëror, të orientuar prej pyetjeve përkatëse, dhe të vëmendshëm për të vlerësuar paragrafët e këtij dokumenti, që konsiderohen të dobishëm dhe të rëndësishëm për të saktësuar projekte jete në lidhje me çdo kontekst specifik dhe në sintoni me ecjen e Urdhrit.



Të angazhuar me Enciklikën <i>Laudato si'</i> .....	49
Të angazhuar me vëllezërit emigrantë dhe refugjatë .....	51
Në botë si mjete të paqes.....	52
Me vizionin e Kishës të papës Françesku .....	53
<b>PËRFUNDIM</b> .....	55
Për t'u rinisur .....	
Ndonjë sugjerim në lidhje me metodën .....	55